

DINASTIA SHQIPTARE E EGJIPTIT 1803-1956

TEMA PËR TITULLIN

MASTER I ARTEVE NË HISTORI E KOHËS SË RE

NGA

ALBIOS ELSHANI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

PRISHTINË

QERSHOR, 2023

## DINASTIA SHQIPTARE E EGJIPTIT 1803-1956

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Nuri Bexheti    Kandidati: Albios Elshani

Ky punim diplome thellohet në një temë shumë intriguese: Dinastia Shqiptare e Egjiptit gjatë periudhës 1803-1956. Gjatë gjithë procesit të realizimit të këtij punimi, theks i madh i është kushtuar dhënies së informacionit të saktë dhe objektiv duke zbatuar metoda të përshtatshme shkencore, si: analiza, sinteza, përshkrimi dhe krahasimi.

Dinastia shqiptare e Egjiptit është zhvilluar në një periudhë historike me interes për historiografinë shqiptare. Fatkeqësisht deri më sot kjo temë nuk e ka pasur vëmendjen e duhur nga historiografia shqiptare dhe si rrjedhojë edhe realizimi i këtij punimi ka hasur në vështirësi për arsye se informacionet kanë qenë të kufizuara dhe të shpërndara. Dinastia shqiptare e Egjiptit është shembulli dhe fakti më i mirë se si dhe sa ishin të inkuadruar figura të ndryshme shqiptare në kuadër të Perandorisë Osmane. Punimi përfshinë një interval relativisht të gjatë kohor 1803-1956, por në mënyrë konstruktive dhe argumentuese do të pasqyrojmë dhe do të vëmë në pah rolin që kishte dinastia shqiptare në themelimin e shtetit modern të Egjiptit.

Ky punim përbëhet nga pesë kapituj dhe disa nënkapituj. Kapitulli i parë i këtij punimi trajton: Egjiptin në kuadër të sundimit osman, me theks të veçantë periudhën e shekullit XIX, pushtimin e Egjiptit nga Napoleon Bonaparti, migrimet e shqiptarëve në Egjipt dhe inkuadrimit të tyre në administratën osmane. Kapitulli i dytë trajton: Egjiptin gjatë qeverisjes së Mehmet Aliut, reformat administrative, ushtarake, zgjerimet territoriale, konfliktin e Mehmet Aliut me Perandorisë Osmane, diplomacinë dhe fundin e Mehmet Alisë. Kapitulli i tretë trajton: Egjiptin mes viteve 1920-1954 udhëheqësit më njohur të Egjiptit gjatë kësaj periudhe dhe Egjiptin gjatë Luftës së Parë Botërore. Kapitulli i katërt dhe i pestë trajtojnë: bashkëpunimin diplomatik të Egjiptit, qeverisjen e Fuadit, qëndrimin e Egjiptit gjatë luftës izraelite-egjiptiane, grusht shtetin e vitit 1952 dhe rrëzimin nga pushteti të dinastisë shqiptare. Në fund të punimit janë paraqitur disa dokumente - fotografi, përfundimi dhe literatura e shfrytëzuar. Me shumë respekt: Albios Elshani